

Vëzhgim mbi konsumin e energjisë dhe nivelin e konfortit të familjeve në banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave



Rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë në banesa është shndërruar në një mision të Entit Kombëtar të Banesave. Synimi ynë është të adresojmë nevojat për strehim, duke siguruar kushte optimale jetese. Në këtë mënyrë, ne kontribuojmë në objektiva madhore të vendit:

1- Sigurimi i strehimit të përballueshëm për shtresat me të ardhura të ulëta dhe të mesme

2- Kursimi i energjisë dhe reduktimi i emetimit të CO₂

Ne do të mbështesim çdo nismë novatore që synon: T'i bëjë banesat tona më të përballueshme nga qytetarët me të ardhura të ulëta; Të rrisë cilësinë e ndërtimit dhe të përmirësoj konfortin e banorëve që përfitojnë nga programet e strehimit që zbaton Enti. Njëkohësisht rritja e cilësisë së ndërtimit reflektohet në një jetëgjatësi më të madhe të banesës, si dhe në kosto më të ulëta përdorimi /mirëmbajtje për familjarët.

Synimi ynë është të adresojmë nevojat për strehim duke siguruar kushte optimale jetese

Për të vënë në zbatim këto nisma dhe për të vjelur ide të reja mbi metodat e ndërtimit që kursejnë energjinë dhe rezultojnë me kosto të përballeshme për qytetarët, Enti do të realizojë një projekt pilot për një banesë me kosto të ulët dhe me përdorim eficient të energjisë, i cili do të realizohet në qytetin e Korçës.

Në kuadër të këtij projekti, Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Korçë, gjatë muajit Nëntor 2014, kreu një vëzhgim me banorë të apartamenteve të financuara nga Enti Kombëtar i Banesave në vite të ndryshme.

Qëllimi i këtij pyetësi ishte vlerësimi i nivelit të konsumit të energjisë, kryesisht për ngrohje, dhe i konfortit të banorëve. Me nivel konforti, kuptohet niveli i temperaturës mesatare të mjediseve që ngrohen, periudha e ngrohjes/ftohjes, lloji i ngrohjes që përdoret, numri i dhomave që ngrohen. Një tjetër qëllim i pyetësit ishte edhe vlerësimi i kostove për energjinë e konsumuar.

Pyetësi u fokusua në katër objekte të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në zonat:

- a- Rruga "Viktor Eftimiu"-Pallati 6 katësh;
- b- Blloku i Ri-Pallati 5 katësh;
- c- Rruga "Gaqo Avrazi"-Pallati 8 katësh;
- d- Bashta e Ushtrisë

Në total, këto objekte kanë 144 apartamente, dy nga të cilat kanë nga 40 apartamente secila, dy kanë nga 20 dhe njëra me 24 apartamente. Objektet janë ndërtuar: Një në vitin 1995, një në vitin 1999, një në vitin 2004 dhe dy (80 apartamente) në vitin 2005-2006. Dy objektet e ndërtuara në vitet 2005-2006, janë me 8 kate, me ashensor, me strukturë b/a dhe mbushje me tulla me bira. Me strukturë b/a dhe mbushje me tulla me bira është ndërtuar edhe objekti 6-katësh, ndërsa objektet e tjera janë me konstruktion mure mbajtës dhe pa ashensor. Intervista u zhvillua në 21 apartamente, të përzgjedhura në mënyrë rastësore, por që të mund të përfaqësonin pozicione të ndryshme të apartamenteve si orientimi dhe kati.



shutterstock: 55505308

Pjesa e Parë – Familja dhe banesa

Nga 21 apartamente, ku u zhvillua pyetësoi me familjet, 8 prej tyre (ose 38%) kanë një strukturë 2+1 me një sipërfaqe mesatare prej 73m². Pjesa tjetër e apartamenteve ka strukturë 1+1 dhe sipërfaqe mesatare prej 60m². Në çdo apartament jetojnë mesatarisht 1,4 familje dhe çdo familje ka mesatarisht 4,6 persona. Çdo person disponon mesatarisht 14m² sipërfaqe ndërtimi.

Nga 21 familje të intervistuar, vetëm 2, ose 10% e tyre raportuan se kishin probleme me banesën. Të dyja këto raste raportojnë se kanë probleme me lagështinë që vjen nga tarraca. Vetëm një familje ka bërë rregullime në banesë, duke ndërruar dritaret.

Të ardhurat mesatare mujore familjare rezultojnë rreth 32,430 lekë. Pyetjes nëse familja paguan për mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta i janë përgjigjur pozitivisht 57% e familjeve. Pagesat mesatare për mirëmbajtjen e pjesëve në bashkëpronësi, janë rreth 518 lekë në muaj.

Orientimi i apartamenteve është si vijon:

J	P	V	JP	VL	VP	L-P	V-J
5%	19%	5%	10%	19%	19%	14%	10%

Pjesa e Dytë – Konsumi i energjisë dhe burimet

Konkluzion

Familjet e trajtuara me strehim në banesat e ndërtuara nga Enti, i përkasin shtresave me të ardhura nën mesataren. Kostot e tyre për energji (për të gjitha llojet e përdorimit: Ngrohje, pajisje, ndriçim, gatim, ujë i ngrohtë), zënë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të tyre. Kushtet e banimit gjatë periudhës së dimrit janë të vështira, duke pasur parasysh temperaturat e ulëta të motit gjatë kësaj periudhe, mungesës së masave për ruajtjen e energjisë në banesë dhe ngrohjes vetëm kryesisht të dhomës së ndenjes.

Përmirësimi i performancës energjetike të banesave që ndërton Enti nuk pritet të ketë aq ndikim në kursimin e energjisë, pasi energjia kursehet nga familjarët, duke mos e përdorur atë dhe duke ulur cilësinë e jetesës. **Përmirësimi i kushteve të jetesës** - Ky është edhe përfitimi kryesor që pritet nga përmirësimi i performancës energjetike të banesave, që do të financohen nga Enti

Një vëzhgim më i hollësishëm, i cili do të kryhet në një fazë të dytë, do të synojë të nxjerrë në pah lidhjen midis kushteve të banimit dhe gjendjes shëndetësore, si edhe nxjerrjen e të dhënave më të hollësishme mbi burimet e energjisë që përdorin familjet për nevoja të ndryshme.

Per çdo pyetje, mund të kontaktoni në adresën:

info@ekb.gov.al



Familjet u pyetën mbi burimin e energjisë që ato përdorin për ngrohje. Sistemi i ngrohjes është në 95% të rasteve individual për çdo dhomë dhe 100% e familjeve përdorin lëndën drusore si burim energjie për ngrohje.

Asnjë familje nuk përdor ftohjen e ambienteve gjatë stinës së verës.

Banorët janë përgjigjur se përdorin ngrohjen për afërsisht 6-7 muaj në vit, duke filluar nga mesi i Tetorit dhe deri në fund të muajit Prill (në varësi të kushteve klimaterike ngrohja mund të zgjasë edhe deri në mesin e muajit Maj).

Çdo familje shpenzon afërsisht 2,295 lekë në muaj për energjinë elektrike. Një familje konsumon në periudhën e dimrit mesatarisht 14 lita dru (ekuivalente me 4.8 – 5.6m³), e cila përkthehet në një kosto prej 25,200 lekë në vit. Gjatë periudhës së dimrit lënda drusore përdoret edhe për gatim. Për shkak të kohës së kufizuar, pyetësi nuk parashikon pyetje të detajuara mbi llojin e energjisë që përdorin familjet për ujin e ngrohtë dhe për gatim në verë. Me të dhënat e disponueshme, rezulton se një familje shpenzon mesatarisht 12% të të ardhurave të saj për energjinë elektrike dhe ngrohjen e vetëm një dhomë të banesës me një temperaturë mesatare prej rreth 22°C. Pa përfshirë energjinë e konsumuar për ngrohje, mesatarisht një familje shpenzon rreth 262Kwh në muaj, ose rreth 3,000 Kwh në vit.